



**RAPORTI PËRMBLEDHËS
I AKTIVITETEVE
TË PLATFORMËS CIVIKOS
2020**



**RAPORTI PËRMBLEDHËS
I AKTIVITETEVE
TË PLATFORMËS CIVIKOS
2020**



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Sweden
Sverige



KFOS
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapu
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo



European Center for
Not-for-Profit Law

ICNL
INTERNATIONAL CENTER
FOR NOT-FOR-PROFIT LAW

PËRMBAJTJA

7	Hyrje
8	Bordi i Platforma Civikos
8	Takimet e Bordit
9	Platforma CiviKos me imazh të ri
9	Bashkëpunimi me OJQ-të anëtare
9	Kampanja #CSOresponse2Covid
11	Diskutime Online
14	OP-ED
16	Bashkëpunimi Qeveri – Shoqëri Civile
16	Këshilli për Bashkëpunim Shoqëri Civile – Qeveri
19	Aktivitetet me anëtarët e Këshillit në zbatim të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile
21	Takimet me Shoqërinë Civile
24	Avokimi për përmirësimin e qasjes në shërbime bankare nga ana e OJQ-ve
27	Ngritja e kapaciteteve në prokurim publik
29	Kampanja #VendoseMaskën
30	Njoftimet përmes Buletinit

HYRJE

Viti 2020 ka qenë viti më sfidues i kohës moderne jo vetëm për Kosovën, por edhe për mbarë botën. Të sfiduar nga pandemia COVID-19, jeta normale u pezullua për të mos u kthyer prapa as pas një viti të plotë në izolim dhe rrethana të jashtëzakonshme të veprimit. Qeveritë në të gjithë botën, përfshirë edhe në Kosovë, kanë ndërmarrë masa të jashtëzakonshme gjatë pandemisë, siç janë izolimi në funksion të menaxhimit të pandemisë.

Demokracia, liritë dhe të drejtat e njeriut, hapësira e veprimit të shoqërisë civile kanë qenë direkt të ndikuara nga këto masa. Organizatat e shoqërisë civile dhe gardianët e të drejtave të njeriut janë përpjekur të kryejnë punën e tyre në mes masave të rrepta të vendosura për të parandaluar COVID-19.

Sipas CiviKos, hapësira e funksionimit të shoqërisë civile në Kosovë është kufizuar gjatë pandemisë. Megjithatë, organizatat e shoqërisë civile – sidomos ato që janë anëtare të Platforma CiviKos, kanë përmbushur misionin e tyre duke qenë urë lidhëse në mes të qytetarëve dhe qeverisë. Ishin pikërisht organizatat e shoqërisë civile ato të cilat kanë qenë në linjën e parë të frontit duke ofruar shërbime nga informimi për qytetarë deri tek ofrimi edhe i pakove ushqimore e higjienike për qytetarët në nevojë. Kurse, fronti tjetër është kujdesur për monitorimin e masave dhe ruajtjen e hapësirës për operim të shoqërisë civile.

Fushata të panumërta janë iniciuar gjatë kësaj kohë, një prej tyre dhe vet nga Platforma CiviKos më organizatat anëtare për ngritjen e vetëdijes për respektimin e masave anti-covid. Fushata të tilla vazhdojnë edhe sot në sfera të ndryshme përfshi edhe atë të sektorit privat.

Kosova gjatë vitit 2020 ka kaluar edhe nëpër krizë paprecedent politike duke ndërruar tre qeveri. Kriza politike ka çuar vendin në zgjedhje të parakohshme. Kjo ka ndikuar shumë në punën e shoqërisë civile përtej menaxhimit të krizës së shkaktuar nga pandemia. Reformat janë pezulluar dhe shumë pak është diskutuar për çështje substanciale. Pas një viti krizë politike, Kosova është në pritje të themelimit të qeverisë së re. E ne na mbetet veç të shpresojmë që qeveria e re do të sjellë edhe stabilitet politik e që shoqëria civile do të funksionojë dhe kontribuojë për procese të mëdha të transformimit demokratik të vendit në funksion të anëtarësimit të Kosovës në BE.

BORDI I PLATFORMA CIVIKOS

Anëtarët e Bordit të Platforma CiviKos

- **Taulant Hoxha** – Kryetar
- **Feride Rushiti** – Anëtare
- **Petrit Tahiri** – Anëtarë
- **Luljeta Demolli** – Anëtare
- **Bujar Kadriu** – Anëtarë
- **Zana Hoxha** – Anëtare

TAKIMET E BORDIT

Platforma CiviKos në fillim të vitit 2020 ka mbajtur takimin e parë të Bordit që nga ndryshimi i menaxhmentit të Platforma CiviKos.

Në takim u diskutua mbi gjendjen aktuale të Platforma CiviKos si dhe zhvillimet nga zgjedhja e drejtoreshës së Platforma CiviKos. Theks të veçantë në këtë takim kishte raporti vjetor narrativ dhe financiar i Platforma CiviKos. Sfidat në vazhdimin e punës së Platforma CiviKos dhe mundësitë e reja në funksion të përmirësimit të shërbimit për organizatat anëtare. Për më tepër, u diskutua rreth bashkëpunimit me Qeverinë (Strategjia 2019- 2023). Përkatësisht, zbatimi i Strategjisë, Roli i Platforma CiviKos dhe anëtarët e shoqërisë civile në Këshill.

Pjesë e diskutimi ka qenë edhe Kuvendi i radhës i anëtarëve dhe mandati i Bordit. Takimi i radhës ishte paraparë të mbahet në muajin e ardhshëm për të finalizuar përgatitjet për Kuvendin e ardhshëm të anëtarëve, por mbyllja totale nga masat për parandalim të përhapjes së pandemisë COVID-19 ka pasur ndikim të dëmshëm në këtë drejtim duke shtyrë këtë takim për kohë të pa caktuar.

Në këtë takim ishin prezent: z. Taulant Hoxha (KCSF), znj. Feride Rushiti (QKRMT), [z.Petrit Tahiri](#) (KEC), znj. Sihana Xhaferi (KFOS), znj. Luljeta Demolli (QKSGj), [znj.Donika Emini](#) dhe z. Dardan Kryeziu (CiviKos).

Për arsye personale ka dhënë dorëheqje nga Bordi znj. Sihana Xhaferi.



PLATFORMA CIVIKOS ME IMAZH TË RI

Viti 2020 kanë qenë vit i sfidave dhe ndryshimeve të mëdha. Për CiviKos ky vit ka qenë viti i imazhit të ri, ku pas një pune të madhe nga ekipi CiviKos së bashku me kompaninë e kontraktuar, CiviKos ka ribrenduar organizatën. Ri-brendimi zyrtarisht është lansuar në tetor 2020.



BASHKËPUNIMI ME OJQ-TË ANËTARE

Platforma CiviKos është duke u rritur në mënyrë të shpejtë, kjo reflekton edhe vullnetin e organizatave të reja për të qenë pjesë e CiviKos. Aktualisht, CiviKos numëron 265 organizata anëtare. Gjatë vitit 2020 janë anëtarësuar 12 organizata joqeveritare.

Bashkëpunimi me organizatat anëtare ka qenë shumë aktiv gjatë vitit 2020 dhe ka ndodhur në shumë forma dhe dimensione.

Gjatë periudhës së mbylljes totale në fillim të pandemisë COVID-19, Platforma CiviKos ka promovuar online aktivitetet e organizatave anëtare të saj gjatë situatës të jashtëzakonshme të shkaktuar nga Pandemia Covid-19.

Promovimi i punës së organizatave anëtare ka qenë nxitje e madhe për të gjithë komunitetin për kontribuar në sfera të ndryshme. Platforma CiviKos ka përdorur llogaritë e saj në rrjetet sociale për të promovuar organizatat.

Kampanja e CiviKos #CSORESPONSE2COVID

Drejtoresha Ekzekutive e Platforma CiviKos - znj. Donika Emini, ka zhvilluar takime të rregullta me institucionet e vendit për promovimin e punës së organizatave të shoqërisë civile në kohë pandemie. Ndër takimet e rregullta, cilësohet edhe takimi me Sekretaren e Përgjithshme në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, me qëllim ri-konfirmimin e mbështetjes për Platforma CiviKos në projektin më të ri që kishte për qëllim ruajtjen e ambientit për Shoqërinë Civile në kohë Pandemie si dhe promovimin e punës së organizatave të Shoqërisë Civile si përgjigje ndaj COVID-19.



Disa nga organizatat anëtare që u promovuan nga Platforma CiviKos, në kuadër të projektit ***“Ri-formësimi i Shoqërisë Civile në Kosovë si pasojë e pandemisë COVID-19”*** mbështetur nga KFOS, janë:

1. *Action for Mother and Children - AMC*
2. *Kosovo Democratic Institute - KDI*
3. *YMCA in Kosovo*
4. *Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarave të Torturës*
5. *ArtPolis*
6. *Community Development Fund - CDF*
7. *Kosova Education Center - KEC*
8. *Syri i Visionit*
9. *Democracy for Development - D4D*
10. *Open Data Kosovo*
11. *Peer Educators Network - PEN*
12. *KCSF*
13. *IPKO Foundation*
14. *Germini*
15. *Center for Counseling, Social Services and Research - SIT*
16. *Democracy Plus*
17. *Solidar Suisse Kosova*
18. *NGO Zana*
19. *Rrjeti CSR Kosova*
20. *NGO Aktive*
21. *EC ma ndryshe*
22. *OJQ Mundësia*

Platforma CiviKos gjatë periudhës së karantinës u ka qëndruar afër organizatave anëtare përmes vizitave dhe ofrimit të mbështetjes në projektet e tyre. YMCA in Kosovo ka qenë njëra ndër organizatat anëtare që u vizitua në qershor 2020, për projektin e tyre inovativ YMCA në Pjetërshan është duke e zhvilluar Qendrën e Edukimit Jo-Formal për të Rinjë dhe Fëmijë - Kamp Pjetërshan. Po ashtu YMCA menaxhon me Qendrën e të Rinjëve në Gjakovë, Dyqanin e Bamirësisë dhe Qendrën për Zhvillim të Ndërmarrjeve Sociale.



DISKUTIME ONLINE

Me qëllim të diskutimit për ndikimin e pandemisë #COVID19 në punën e shoqërisë civile në Kosovë, Platforma CiviKos ka mbajtur diskutime online në kuadër të projektit “Ri-formësimi i Shoqërisë Civile në Kosovë si pasojë e pandemisë COVID-19” i mbështetur nga Fondacionin Kosovar për Shoqëri të Hapur - KFOS.

Ndikimi i COVID-19 në punën e shoqërisë civile në Kosovë

Pandemia globale COVID-19 ka pasur ndikim shumë të madh në punën e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë. Masat që i ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës kanë ri-definuar punën dhe operimin e sektorit të shoqërisë civile. Përderisa fokusi kryesor ka qenë adaptimi dhe tranzicioni në punë online për të siguruar vazhdimësi në punën e shoqërisë civile, pak vëmendje i është kushtuar implikimeve që do të kenë këto masa në rrudhjen e hapësirës për funksionim të organizatave të shoqërisë civile.

Gjatë takimit u diskutuan çështjet si në vijim:

- Cili ka qenë ndikimi i pandemisë në punën e shoqërisë civile në Kosovë?
- Ri-formësimi i punës së shoqërisë civile: cili është kontributi i këtij sektori në kohë pandemie?
- Fondet për organizata të shoqërisë civile: a mund të ketë tkurrje të fondeve për shkak të krizës globale ekonomike?

Ky takim online kishte panelistë: z. Taulant Hoxha - Drejtor Ekzekutiv, Fondacioni i Kosovës për Shoqëri Civile (KCSF); znj. Visare Gorani - Menaxhere e Programit, Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar, SIDA; z. Veton Mujaj - Drejtor Ekzekutiv, Syri i Vizionit. Moderuar nga znj. Donika Emini - Drejtore Ekzekutive, Platforma CiviKos.

The poster features the CiviKos logo at the top left. The title 'NDIKIMI I COVID-19 NË PUNËN E SHOQËRISË CIVILE NË KOSOVË' is prominently displayed in blue. Below the title, the date and time 'Zoom / 24 Qershor 2020 / 13:00 – 14:30' are listed. Four circular portraits of the participants are shown: Donika Emini (Moderator), Taulant Hoxha (Panelist), Visare Gorani (Panelist), and Veton Mujaj (Panelist). At the bottom left is the KFOS logo, and at the bottom right is a small text block providing context about the project.

platforma
CiviKos

**NDIKIMI I COVID-19 NË PUNËN
E SHOQËRISË CIVILE NË KOSOVË**

Zoom / 24 Qershor 2020 / 13:00 – 14:30

MODERATORE
DONIKA EMINI

PANELISTËT
TAULANT HOXHA

VISARE GORANI

VETON MUJAJ

KFOS
Kosovian Foundation for Open Society

Ky aktivitet i Platforma CiviKos është i mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) në kuadër të projektit:
"Ri-formësimi i Shoqërisë Civile në Kosovë si pasojë e pandemisë COVID-19".

COVID-19 DHE MEDIA: Roli i gazetareve në pandemi globale

CiviKos ka mbajtur edhe një tjetër takim online që kishte për temë diskutimi rolin e gazetarëve dhe medias në pandemi globale, sfidat dhe vështirësitë e raportimit, qasjen në informacion si dhe transparencën e institucioneve në kohë krize, me penalistë: znj. Dorentina Thaci - KTV, znj. Gentiana Hasani - T7, znj. Jehona Zhitia – RTK, dhe me input nga znj. Flutura Kusari - juriste e së drejtës së medias/ECPMF.

The poster is for a Zoom event titled "COVID 19 DHE MEDIA: ROLI I GAZETAREVE NË PANDEMI GLOBALE" held on 15 Korrik 2020 from 16:00 to 17:30. It features the CiviKos logo and four panelists: Dorentina Thaci (KTV), Gentiana Hasani (T7), Jehona Zhitia (RTK), and Flutura Kusari (juriste e së drejtës së medias/ECPMF). The KFOS logo is also present at the bottom left.

platforma
CiviKos

**COVID 19 DHE MEDIA:
ROLI I GAZETAREVE NË PANDEMI GLOBALE**

Zoom / 15 Korrik 2020 / 16:00 – 17:30

PANELISTE

DORNTINA THACI
KTV

GENTIANA HASANI
T7

JEHONA ZHITIA
RTK

ME INPUT NGA:

FLUTURA KUSARI
JURISTE E SË DREJTËS SË MEDIAS/ ECPMF

KFOS
Kosovo Foundation for Open Society

Ky aktivitet i Platformës Civikos është i mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Rapur (KFOS) në kuadër të projektit "Rëformimi i Shoqërisë Civile në Kosovë si pasqyë pandemisë COVID-19".

Pandemia globale COVID-19 ka pasur ndikim shumë të madh në punën e mediave në Kosovë. Për të informuar publikun gjatë kësaj periudhe të pa precedent, mediat kanë luajtur rol të rëndësishëm në mbulimin aktiv të krizës shëndetësore në Kosovë si pasojë e COVID19. Mirëpo, natyra gjithnjë e në ndryshim i ka lënë gazetarët me shumë sfida në sigurimin e informacionit të saktë për publikun, ka vështirësuar qasjen në informacion si dhe ka ngritur debate në lidhje me respektimin e standardeve etike me fokus në privatësi.

Gjatë takimit u diskutuan çështjet si në vijim:

- Sa kanë qenë transparente institucionet e Kosovës gjatë periudhës së pandemisë COVID-19.
- Sa ka ndikuar pandemia në jetën e qytetarëve? Çfarë është parë nga raportimi në terren.
- Cilat kanë qenë vështirësitë që janë hasur gjatë raportimit në terren.
- A janë marrë masa rreth mbrojtjes së gazetarëve në terren gjatë pandemisë, dhe a ka pasur respektim të standardeve etike me fokus në privatësi.

COVID-19: Transparenca në prokurim publik në kohë pandemie

Takimi tjetër online i zhvilluar nga Platforma CiviKos kishte për temë diskutimi prokurimin publik në kohë pandemie me panelistë: znj. Albulena Nrecaj, Drejtore Ekzekutive – Iniciativa për Progres – INPO; z. Arton Demhasaj, Drejtor Ekzekutiv - Organizata Çohu/Preportr; Me facilitim të: znj. Diana Metushi Krasniqi, Menaxhere e Programit – Instituti Demokratik i Kosovës (Kosova Democratic Institute / Transparency International Kosova).

The poster features the CiviKos logo at the top left. The title 'COVID 19: TRANSPARENCA NË PROKURIM PUBLIK NË KOHË PANDEMIE' is prominently displayed in purple. Below the title, the date and time 'Zoom / 29 Korrik 2020 / 13:00 – 14:30' are listed. Three circular portraits of the participants are shown: Albulena Nrecaj, Arton Demhasaj, and Diana Metushi Krasniqi. Below each portrait, their names and titles are provided in purple and black text. At the bottom left is the KFOS logo, and at the bottom right is a small text block in Albanian.

platforma
CiviKos

**COVID 19: TRANSPARENCA NË PROKURIM PUBLIK
NË KOHË PANDEMIE**

Zoom / 29 Korrik 2020 / 13:00 – 14:30

PANELISTE **ALBULENA NRECAJ**
DREJTORE EKZEKUTIVE
INICIATIVA PËR PROGRES (INPO)

ARTON DEMHASAJ
DREJTOR EKZEKUTIV
ORGANIZATA ÇOHU / PREPORTR

ME FACILITIM TË: **DIANA METUSHI KRASNIQI**
MENAXHERE E PROGRAMIT
INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS (NDI)

KFOS
Kosova Democratic Institute / Transparency International Kosova

Ky aktivitet i Platforma Civikos është i mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) në kuadër të projektit: "Riformësimi i Shoqërisë Civile në Kosovë si pasqje pandemisë COVID-19".

Pandemia e COVID-19 kërkoj që autoritetet publike të prokurojnë produkte dhe shërbime nga sektori privat me një urgjencë të paprecedent. Përveç prokurimit në sektorin e shëndetësisë, rrethanat e krijuara nga COVID-19 kanë pasur ndikim edhe në aktivitetet tjera prokurorese kurse mungesa e transparencës ka rritur edhe më tej rrezikun për korrupsion.

Andaj në këtë takim u diskutuan çështjet si në vijim:

- Cilat ishin sfidat e shoqërisë civile në analizimin e prokurimeve publike gjatë pandemisë.
- Sa i ka lehtësuar hulumtimet platforma e-Prokurimi?
- A do të duhej që Qeveria të rriste transparencën gjatë kësaj periudhe?
- A do të mund të kontribuonte shoqëria civile në një qeverisje të mirë në kohë emergjencash?
- Çfarë mund të bëjmë më tej për të përmirësuar proceset, sistemet dhe të dhënat tona të prokurimit?
- Sa ka ndikuar pandemia në realizimin e planeve të Prokurimit dhe projekteve aktuale të institucioneve?
- Pandemia nuk po përfundon. Çfarë më tutje? Çka do të duhej të bënte shoqëria civile për mbikëqyrje dhe parandalim të keq menaxhimeve? A do të duhej që qeveria të rriste bashkëpunimin me shoqërinë civile, sidomos gjatë pandemisë në monitorim dhe happe të të dhënave?

OP-ED

OP-ED kanë qenë një nga aktivitetet risi të Platforma CiviKos gjatë vitit 2020, me ndikim tek shoqëria. Gjithsej janë publikuar tre (3) OP-ED, që kanë qenë në kuadër të projektit: “Ri-formësimi i Shoqërisë Civile në Kosovë si pasojë pandemisë COVID-19” zbatuar nga Platforma CiviKos, dhe mbështetur nga Kosovo Foundation for Open Society (KFOS).

“Bashkëpunimi i shoqërisë civile me Qeverinë të fokusohet në procesin e dialogut” shkruar nga Albert Krasniqi dhe publikuar në Sbunker.

“Përveç ushtrimit të veprimtarisë si organizata individuale, organizatat e shoqërisë civile kanë avancuar për nga mënyra e organizimit duke bashkuar energjitë përmes krijimit të rrjetëzimeve për tema të caktuara. Këto rrjete sot i hasim duke avokuar për barazi gjinore, duke kontribuar në transparencën e zgjedhjeve, apo edhe mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të fëmijëve.” *OP-ED-in e polotë mund ta lexoni në vegzën [këtu](#).*

BOTIME / S'TATUS / OP-ED / NEPER TEH / BLLOGJE / PERBALI

Bashkëpunimi i shoqërisë civile me Qeverinë të fokusohet në procesin e dialogut


1.

Shoqëria civile paraqet një nga shtyllat kryesore të funksionimit të një shoqërie demokratike. Roli i shoqërisë civile është vital për demokracinë. Organizatat e shoqërisë civile paraqesin një mënyrë alternative të mbrojtjes së interesave të qytetarëve, kanalizimit të pikëpamjeve të ndryshme, prezantim të interesave tek vendim-marrësit apo edhe të ofrimit të shërbimeve sociale. Ky rol kaq i gjerë i shoqërisë civile në sferën publike nuk ka kaluar pa u kontestuar. Për disa studiues, akterët e shoqërisë civile kanë fituar shumë pushtet politik pa qenë të zgjedhur apo të emëruar nga askush. Shikuar nga perspektiva teorike, organizatat e shoqërisë civile janë pjesë e demokracisë pjesëmarrëse dhe jo demokracisë përfaqësuese. Ato nuk janë trupa të zgjedhur por grumbullime të qytetarëve rreth një qëllimi të caktuar. Legjitimiteti i tyre buron nga pjesëmarrja në procese publike për çështjet të cilat i adresojnë.

23 qershor 2020
14:45



Albert Krasniqi



“Viti i mbrapsht për transparencën në prokurimin publik në Kosovë” OP-ED i dytë shkruar nga Diana Metushi-Krasniqi, publikuar në Sbunker.

Por si ishte situata në Kosovë? Gjatë periudhës shkurt – korrik 2020 u zhvilluan mbi 180 prokurime të mbyllura emergjente. Për më shumë, transparenca në shpenzimet publike, për të cilën shoqëria kosovare kishte luftuar me dekada të tëra, u mbyl fare. OP-ED-in e polotë mund ta lexoni në vegzën [këtu](#).

BOTIME / S'TATUS / OP-ED / NEPER TEH / BLLOGJE / PERBALI

Viti i mbrapsht për transparencën në prokurimin publik në Kosovë

Derisa bota po diskutonte rreth rregjikut me një armik të ri, e të pa dukshëm, që po shpërndahej me një hov marramendës, Kosova ende ishte në diskutime për themelimin e qeverisë. Dukej sikur ne nuk e kishim për ngut të përgatitshëm për atë me të cilën po ballafaqohej i gjithë globi. Kishim gajen e ndarjes së pozitive dhe prioriteteve qeveritare, e jo parapërgatitjen për ballafaqimin me këtë armik të pamëshirshëm. Por kjo nuk është historia e re për ne. Qeverinë e Kosovës ende e befason dëbora në dhjetor. Ndoshta kjo pse Kosova për shekuj ishte ndër vendet më të izoluar, dhe thjeshtë në vete kemi krijuar një bindje se ajo çfarë ndodhe në botë, vështirë që arrin tek ne.

Tre ditë pasi Organizata Botërore e Shëndetësisë kishte shoallur COVID-19 një emergjencë të shëndetit publik në nivel ndërkombëtar, në Kosovë, më në fund u themelua Qeveria. Derisa tregjet globale po mbylleshin, oferta po zvogëlohej e kërkesa po rritej, Qeveria e re e Kosovës ishte

06 gusht 2020
13:39



Diana Metushi-Krasniqi



Roli i Shtetit në Përfshirjen Financiare të OJQ-ve: Pse bankat komerciale po i largojnë OJQ-të nga lista e klientëve? shkruar nga Dren Puka për Platforma Civikos që u publikua në Sbunker.

Gati gjysma e OJQ-ve aktive në Kosovë operojnë me zero të hyra vjetore (45%), derisa shpenzimet për mirëmbajtje të llogarisë bankare për një organizatë shkojnë deri në 200 EUR në vit. Edhe pse shumica dërrmuese e fondeve për OJQ vijnë nga donatorët e huaj, ku prijnë Bashkimi European me vendet anëtare dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe fondet publike, OJQ-të konsiderohen si entitete me rrezik për financim të terrorizmit. OP-ED-in e polotë mund ta lexoni në vegzën [këtu](#).

BOTIME / STATUS / OP-ED / NEPER TEH / BILLOGJE / PERBALL

Roli i Shtetit në Përfshirjen Financiare të OJQ-ve: Pse bankat komerciale po i largojnë OJQ-të nga lista e klientëve?

Gati gjysma e OJQ-ve aktive në Kosovë operojnë me zero të hyra vjetore (45%), derisa shpenzimet për mirëmbajtje të llogarisë bankare për një organizatë shkojnë deri në 200 EUR në vit. Edhe pse shumica dërrmuese e fondeve për OJQ vijnë nga donatorët e huaj, ku prijnë Bashkimi European me vendet anëtare dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe fondet publike, OJQ-të konsiderohen si entitete me rrezik për financim të terrorizmit.

05 gusht 2020
13:48



Dren Puka

Në kuadër të angazhimeve për luftim të terrorizmit në vitet 2014 dhe 2015 patën ndodhur disa zhvillime të rëndësishme dhe të pa precedent për sa i përket kufizimeve për punën e OJQ-ve në Kosovë dhe ndërhyrjes së drejtpërdrejtë të organeve shtetërore dhe bankave komerciale në punën e tyre.



Fillimisht, në vitin 2014 me kërkesë të organeve të sigurisë Departamenti për OJQ pati pezulluar punën e 14 organizatave të shoqërisë civile, nën arsyetimin se ekziston dyshim i bazuar që veprimtaria e OJQ-ve të

BASHKËPUNIMI QEVERI – SHOQËRI CIVILE

Këshilli për bashkëpunim Qeveri - Shoqëri Civile

Këshilli për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri është mekanizmi kryesor që koordinon procesin e bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile. Këshilli ka 29 anëtarë, 15 anëtarë janë nga shoqëria civile të zgjedhur në mënyrë demokratike nga vet organizatat e shoqërisë civile përmes Platforma Civikos, dhe 14 anëtarë janë të emëruar drejtpërdrejt nga qeveria.



Me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të favorshëm për funksionim të shoqërisë civile në Kosovë, Qeveria e Kosovës ka hartuar dy strategji për bashkëpunim me shoqërinë civile (2013 – 2017) dhe (2019 – 2023). Këto dokumente kanë listuar katër objektiva strategjike implementimi i të cilave monitorohet nga Këshilli. Dokumentin e plotë të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023 mund ta gjeni [këtu](#).



KËSHILLI PËR BASHKËPUNIM TË QEVERISË ME SHOQËRINË CIVILE 2019-2023, NDARË NË GRUPE PUNUES

Zyra e Qeverisë së Mirë / Zyra e Kryeministrit

Civilis Kos

GRUPI PUNUES I

OBJEKTIVA

Rritje e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë-bërje

GRUPI PUNUES II

OBJEKTIVA

Përmirësimi i kornizës institucionale dhe ligjore për financim në zhvillimin e qëndrueshëm të programeve dhe projekteve të OSHC-ve me interes publik

GRUPI PUNUES III

OBJEKTIVA

Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike

GRUPI PUNUES IV


OBJEKTIVA

Rritja e vullnetarizmit në programet me interes publik

Platforma CiviKos së bashku me Zyrën për Qeverisje të Mirë - ZQM në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës kanë lehtësuar zbatimin e Strategjisë së parë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017.



Sekretariati i Platforma CiviKos ka monitoruar zbatimin e kësaj strategjie, ku përmes infografikave më poshtë janë paraqitur të arriturat kryesore dhe sfidat në zbatim të strate-
gjisë për katër objektivat strategjike.






Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë-bërje është objektiva e parë e Strategjisë së Qeverisë për bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019.

Rregullorja për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit me Publikun (Nr.05/2016) është miratuar në 2016. Platforma online për Konsultim Publik është lansuar në muajin shkurt 2017. Në këtë platformë mund të regjistrohen të gjithë personat që kanë interesim dhe vullnet për të ndikuar në politikë bërje.

Kjo platformë është e qasshme përmes këtij linku: <https://konsultimet.rks-gov.net/>

Disa të dhëna që janë gjeneruar nga raporti i publikuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) sa i përket konsultimit publik për vitet 2017, 2018, dhe 2019 përmes infografikave.



Aktivitetet me anëtarët e Këshillit në zbatim të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile

Platforma Civikos ka mbajtur sesionin informues me anëtarët e shoqërisë civile pjesë e Këshillit për Bashkëpunim Shoqëri Civile-Qeveri, në Janar 2020.

Ky sesion informues është mbajtur nga z. Taulant Hoxha - Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile dhe ish anëtarë i Këshillit në periudhën 2013-2017. Qëllimi i këtij takimi ishte njoftimi i anëtarëve të ri të Këshillit mbi historikun dhe parimet e përgjithshme të punës së Këshillit për Bashkëpunim Qeveri – Shoqëri Civile, rolin e anëtarëve të Këshillit – bazuar në përvojat nga Këshilli i kaluar, si dhe mundësitë e Këshillit aktual, sipas objektivave strategjike.



Lansimi i Platformës Online për Financimin Publik të OShC-ve

Në mars 2020, Zyra për Qeverisje të Mirë në bashkëpunim me CiviKos kanë organizuar konferencë për lansimin e platformës online për financim publik të OSHC-ve, e cila platformë do të rris transparencën në ndarjen e fondeve publike.

Platformën mund ta vizitoni në këtë vegëz [këtu](#).

REPUBLICA E KOSOVËS
QEVERIA - ZYRA E KRYEMINISTRIT
ZYRA PËR QEVERISJE TË MIRË

Shqip ▾

BALLINABAZA E TË DHËNAVEVIZUALIZIMI I TË DHËNAVEDOKUMENTETI THIRRIJET PUBLIKEKONTAKTI

Përfshihu në monitorimin e financimit publik të OJQ-ve

RRETH PLATFORMËS

Mirësevini në platformën qendrore qeveritare për financimin publik të organizatave të shoqërisë civile në Republikën e Kosovës.

Platforma ka për qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies për financimin publik të organizatave të shoqërisë

BAZA E TË DHËNAVE TË FINANCIMIT TË OJQ-VE

Këtu mund të kërkonti të dhëna për mbështetje financiare publike për OJQ-të në Kosovë që nga viti 2015. Të dhënat janë mbledhur nga raportet zyrtare të përgatitura nga Zyra e Kryeministrit / Zyra e Qeverisjes së Mirë, Ministria e Financave dhe në përputhje me

VIZUALIZIMI I TË DHËNAVE

Kjo pjesë e platformës ju ofron mundësinë për vizualizimin e të dhënave të grumbulluara nga sektorë të ndryshëm të nivelit qendror dhe lokal të qeverisjes mbi fondet publike të cilat lu janë chënë Organizatave Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

Takimet me Shoqërinë Civile

Takimi i rregullt i Këshillit për Bashkëpunim Qeveri - Shoqëri Civile

Këshilli për bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri ka mbajtur disa takime gjatë vitit, ndërsa i fundit ishte në dhjetor 2020. Qëllimi i takimit ishte prezantimi dhe diskutimet për zhvillimet kryesore gjatë periudhës së pandemisë në procesin e bashkëpunimit të Qeverisë me Shoqërinë Civile, gjetjet kryesore për të arriturat dhe sfidat në zbatimin të strategjisë gjatë kësaj periudhe, punën e Këshillit dhe prezantimet nga koordinatorët e ekipeve për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve e planifikuara për vitin 2020 të Plani i Veprimit.

Takime të rregullta me Zyrën për Qeverisje të Mirë

Përfaqësues të Platforma CiviKos kanë mbajtur takim me Zyrën për Qeverisje të Mirë - ZQM, dhe përfaqësuesen nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për të diskutuar rreth aktiviteteve të Objektivës 3 të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2019-2023. Pandemia e ka vështirësuar zhvillimin normal të aktiviteteve të parapara me plan të punës. CiviKos së bashku me partnerët mbeten të përkushtuar në realizim të objektivave strategjike të parapara me Strategji.




DISKUTIM online: “(Mos)Përfshirja e OJQ-ve në Pakon për Rimëkëmbje Ekonomike”

Me kërkesë të disa organizatave anëtare Platforma CiviKos ka organizuar diskutimin online: “(Mos)Përfshirja e OJQ-ve në Pakon për Rimëkëmbje Ekonomike”, më 16 dhjetor 2020.

Ky diskutim u organizua në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë (ZQM/ZKM) dhe kishte për qëllim të mbledhë përfaqësues nga Qeveria e Kosovës dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile me

qëllim të de-konstruktimit të pakos për rimëkëmbje ekonomike me fokus në sektorin e shoqërisë civile.


Diskutimi u lehtësua nga Platforma CiviKos, ndërsa penalistë ishin: Z. Besnik Tahiri - Zëvendës Kryeministër i Republikës së Kosovës; Z. Habit Hajredini - Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit.



Raporti me infografika “Dy Qeveri - Një Pandemi”

Platforma CiviKos në tetor 2020 ka publikuar raportin “Dy Qeveri - Një Pandemi” të ilustruar me infografikë mbi monitorimin e masave kundër COVID-19 në Kosovë. Raporti përfshin periudhën mars-gusht 2020 dhe përmban vendimet e dy qeverive – për mblylljen e rreptë dhe hapjen problematike.

Raportin e plotë mund ta gjeni [këtu](#).



Vala e dytë - Masat e Qeverisë së Kosovës

Platforma CiviKos ka qenë në vazhdim monitoruese e masave të Qeverisë lidhur me pandeminë Covid-19. Infografika mbi monitorimin e masave të Qeverisë së Kosovës kundër #COVID19, bazuar në VENDIMIN: “Për masat e veçanta për mbrojtjen nga pandemia COVID-19”, NR. 01/39; Datë 01.11.2020, i është shtuar raportit “Dy Qeveri - Një Pandemi” si vazhdimësi.

Infografikën gjeni [këtu](#).



Çfarë thotë Raporti i Progresit i Komisionit European për shoqërinë civile? - Infografikë

Pas publikimit të Raportit të Progresit për Kosovë. Sekretariati i Platforma CiviKos ka përkthyer dhe përshtatur të gjeturat kryesore të Raportit të Progresit për shoqërinë civile.

Në këtë infografikë mund t'i lexoni të gjeturat kryesore. Vegëza për infogrfikë është [këtu](#).



Avokimi për përmirësimin e qasjes në shërbime bankare nga ana e OJQ-ve

Takim me Guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës

Pas kërkesës së shumë organizatave të shoqërisë civile që kanë ardhur në adresë të Platforma CiviKos në lidhje me problemet që OJQ-të po ballafaqohen në qasjen në shërbime bankare në Kosovë, përfaqësuesit e Platforma CiviKos, Donika Emini dhe Dardan Kryeziu, së bashku me Dren Puka nga KCSF, njëherësh anëtar i grupit punues nga shoqëria civile për rishikimin e legjislacionit kundër shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, u takuan me Guvernatorin e Bankës Qendrore z. Fehmi Mehmeti, në mars 2020.



Gjatë këtij takimi, Guvernatori u njoftua për së afërmi me disa nga problemet që OJQ-të po ballafaqohen me bankat komerciale nga procesi i hapjes së llogarive bankare, mirëmbajtjes së tyre e deri tek tarifat e shtrenjta që bankat po aplikojnë për mirëmbajtje të llogarive për OJQ.

Z. Mehmeti na njoftoi se Banka Qendrore e Kosovës është duke punuar një rregullore e cila rregullore do të unifikoj çmimet e shërbimeve bankare në Kosovë. Me ç'rast, e ftoi z. Dren Puka të marr pjesë në një takim në mes të BQK dhe përfaqësuesve të bankave komerciale që operojnë në Kosovë ku do të adresoj problemet e ngritura nga shoqëria civile.

Qasja e OJQ-ve në shërbimet financiare, me fokus identifikimi i pronarit përfitues

Platforma CiviKos me mbështetje nga International Center for Not-for-Profit Law (ICNL) dhe European Centre for Non-profit Law (ECNL) kanë organizuar takim mes palëve të interesit për qasjen e OJQ-ve në shërbimet financiare, me fokus identifikimi i pronarit përfitues, në shtator 2020.



OJQ-të në Kosovë po vazhdojnë të ballafaqohen me probleme në shërbimet bankare. Përfashtimi financiar i OJQ-ve është një fenomen global dhe mohimi i qasjes në shërbimet financiare të shoqërisë civile prek një sërë të drejtave të njeriut. Rregullimi i pronarit përfitues është një sfidë tjetër për OJQ-të.




Përveç përfaqësues të OJQ-ve, ne tryezë ishin edhe përfaqësues nga institucionet publike, si: Ministria e Punëve të Brendshme – Departamenti për OJQ, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Banka Qendrore e Kosovës si dhe përfaqësues nga Shoqata e Bankave të Kosovës.

Ekspertet nga ‘Human Security Collective’ kanë ndarë disa praktika të mira evropiane rreth identifikimit të pronarit përfitues.

CiviKos së bashku me organizatat partnere, dhe me institucionet relevante si Banka Qendrore, Shoqata e Bankave të Kosovës, Njësia e Inteligjencës Financiare do të punojnë së bashku për të lehtësuar qasjen e OJQ-ve në shërbime bankare.


Punëtori: Ndikimi i legjislacionit kundër shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit në punën e shoqërisë civile në Kosovë

Platforma CiviKos së bashku me European Centre for Non-profit Law (ECNL), më 1 dhjetor 2020 organizuan një punëtori gjysmë-ditore për organizata të shoqërisë civile në Kosovë për të kuptuar më shumë rreth ndikimit që ka legjislacioni kundër shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit në punën e shoqërisë civile në Kosovë?



Dren Puka nga KCSF prezantoi reth:

- Proceseve që Kosova është duke kaluar për rishikim të legjislacionit në këtë fushë?
- Problemet e OJQ-ve në qasjen të shërbimeve në bankat komerciale.
- Përfshirja e shoqërisë civile në këtë proces.



Sangeeta Goswami nga Human Security Collective - Holand dhe Eszter Hartay nga European Centre for Non Profit Law sollën praktikat nga vendet e ndryshme europiane.

RYCO: Lehtësimi i përzgjedhjes së përfaqësuesit rinor në Bordin Drejtues të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në gusht 2020 ka shpallur thirrje të hapur për përzgjedhjen e Përfaqësuesit të të Rinjve në Bordin Drejtues të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO).

Platforma CiviKos ka lehtësuar procesin e përzgjedhjes së këtij përfaqësuesi.



Takimi i komisionit për numërimin e votave të kandidateve për përfaqësuesin e të rinjve në Bordin Drejtues të RYCO-s u mbajt me 18 gusht 2020, i përbërë nga: 1. Xhevat Bajrami – MKRS; 2. Dardan Kryeziu – CiviKos; 3. Arianit Jashari – Ish Anëtar i Bordit të RYCO. Dhe anëtar vëzhgues ishin: 1. Flakadon Osmani; 2. Egzon Pacolli.

Pas numërimit të votave, komisioni konstatoi se gjithsej kanë votuar: 245 vota me post elektronike (email), 143 vota me post (pliko të mbyllura)


Pas numërimit të votave, Edis Prapashtica është përzgjedhur si përfaqësues i të rinjve në Bordin e RYCO me 172 vota.

NGRITJA E KAPACITETEVE NË PROKURIM PUBLIK NË KUADËR TË PROJEKTI KOMUNAT TRANSPARENTE, EFEKTIVE DHE LLOGARIDHËNËSE


Platforma CiviKos, me 3 shkurt 2020 kishte hapur thirrje për organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në nivel lokal, si dhe anëtarët e Këshillave të Qytetit/Fshatrave dhe grupeve tjera jo formale të cilët janë të interesuar të fitojnë njohuri të avancuara në monitorim të prokurimit publik, duke përfutur nga punëtoritë mbi mësimin e aplikueshëm. Këto punëtori të ofruara nga CiviKos dhe ekspertë të organizatave anëtare synojnë fuqizimin e shoqërisë civile në monitorim të prokurimit publik dhe ekspozimit të korrupsionit në nivel lokal.

Projekti më proaktiv i Platforma CiviKos i zbatuar në kuadër të Projektit të USAID Komunitat Transparente, Efektive dhe Llogaridhënës.


Më 12 Maj 2020, serinë e re të mbështetjes së organizatave lokale me metodologji të re të monitorimit të prokurimit publik në nivel lokal. Për shkak të pandemisë takimi i parë i organizatave nga rajoni i Prizrenit u zhvillua online me facilituesen Diana Metushi Krasniqi.




Pastaj u mbajt takimi i parë i organizatave nga rajoni i Mitrovicës që po ashtu u zhvillua online me facilituesin Visar Prebreza.





Në maj 2020, ka vazhduar takimi i parë i organizatave nga qytetet: Pejë, Gjakovë, Klinë, Istog, me facilituesin Artan Demhasaj.





Në qytetin e Ferizajit, takimi i parë me organizatat lokale ka vazhduar më 28 Maj 2020, me facilituesen Albulena Nrecaj.

Ndërsa në qershor 2020, filloj takimi me organizatat nga Gjilani dhe Kamenica, me facilituesen Albulena Nrecaj.



Si dhe në Prishtinë, me 5 qershor 2020 filloj takimi i parë me organizatat e rajonit të Prishtinës, me facilituesin Visar Prebreza.

Me 15 Shtator 2020 Platforma CiviKos ka organizuar trajnimin dy ditor mbi monitorimin e prokurimit publik me pjesëmarrësit nga organizatat e shoqërisë civile nga rajoni i Mitrovicës së Veriut.



KAMPANJA #VENDOSEMASKËN

Platforma CiviKos në bashkëpunim me organizatat Artpolis - Art and Community, Democracy Plus, PEN - Peer Educators Network, KCSF - Fondacioni Kosovar për Shoqëri civile, dhe YMCA in Kosovo filluan kampanjën online #VendoseMaskën që kishte për qëllim ngritjen e vetëdijes së qytetarëve të Kosovës mbi rëndësinë e përdorimit të maskave në ambiente publike.



Kampanja online #VendoseMasken filloj më 16 Qershor 2020 me një aksion simbolik përmes shpërndarjes së disa maskave në disa pika në qytetin e Prishtinës.

Lokacionet ku do të shpërndahen maskat ishin:

- Platforma CIVIKOS - Rruga "Tringë Smajli";
- ARTPOLIS- Para Teatrit Kombëtar;
- DEMOCRACY PLUS- Rruga "Justiniani" (para hyrjes në nënkalim);
- PEN – Stacionet e Autobusëve Urban (tek Katedralja dhe tek Rektorati);



- FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE (KCSF) - Pallati i Rinisë (para New Born);
- YMCA - Rruga “Qamil Hoxha” (afër Ministrisë të Kulturës Rinisë dhe Sportit).

Pas lansimit të kampanjës online dhe aksionit për shpërndarjen e maskave Platforma CiviKos inkurajoi organizatat e shoqërisë civile që të promovojnë këtë kampanjë online si dhe të ndërmarrin aksione të ngjashme në të gjitha qytetet e Kosovës.

Kjo kampanjë u realizua në formë vullnetare nga Platforma CiviKos në bashkëpunim me organizatat e tjera, mediat e ndryshme vendore, ku u bashkëngjiten edhe shume qytetarë dhe fytyra publike për ngritjen e vetëdijes dhe mbrojtjen e shëndetit.



Kampanja vazhdoi edhe në: Vushtri, Mitrovicë, Pejë, Prizren, dhe qytete tjera të Kosovës.

Në kuadër të kampanjës #VendoseMasken, Platforma CiviKos ka dhuruar maska në organizatat The Ideas Partnership dhe Balkan Sunflowers Kosova në Fushë Kosovë, qendra këto ku zhvillojnë aktivitete për fëmijët dhe të rinjtë e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që jetojnë në Fushë Kosovë. Ky aktivitet është realizuar në kuadër të projektit: “Ri-formësimi i Shoqërisë Civile në Kosovë si pasojë pandemisë COVID-19” mbështetur nga Kosovo Foundation for Open Society (KFOS).



SHËRBIMI INFORMUES PËR ORGANIZATA ANËTARE

Gjatë viti 2020 janë dërguar 101 buletinë informues, ku nga ato 51 Buletine Javore të regullta.

Audienca që marrin shërbimin informative janë të gjithë nga organizatat anëtare të Platforma Civikos, ku emaili u dërgohet 402 përdoruesve shqipfolës dhe 20 serbishtfolës.

